

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbështetje për programin 2024-2026”: Paketa F: Shërbimi i mbikqyrjes së punimeve për Përmirësimi i Transportit dhe Aksesit nepermjet nderhyrjeve në Rrugët e Bardha, Rajoni 1 dhe 2, Rajoni 3 dhe 4 (Faza II) etj.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV)- 71247000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,812,500 lek pa tvsh. Financimi i këtij objekti është parashikuar në programet buxhetore për periudhën 2024-2026. Kodi Output: 24AD301..

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **FSHZH** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithsme sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të më e vogël se vlera e perlllogaritur e fondit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është ”Hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa ”b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në mbështetje të nenin 43, pika 2/b ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislativës të fushës, konkretisht, *ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% të vlerës së perlllogaritur te fondit qe prokurohet**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”

Kriteri është miratuar me qëllim vërtetimin për eksperiencat e ngjashme të operatorit/ëve në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin e objektit të kontratës.. Përvoja e operatorit është element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Në kuptim të nenit 41 të VKM-se vlerësohet vlera e kërkuar në masën 40 % e cila është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të operatorëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për kryerjen e shërbimit objekt kontrate të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme

Për mbikqyrjen e punimeve të përgjithshme të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.P – 1. Punime gërmimi në tokë.
- N.P – 4. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 5. Punime nëntoksore, ura e vepra arti.

Për mbikqyrjen e punimeve speciale të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.S – 1. Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 5. Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut
- N.S – 6. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese
- N.S – 18. Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale profesionale të individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit të ndërtimit dhe mbikeqyrje e kolaudimit të punimeve miratura me VKM- ne, Nr.759, date 12.11.2014 i ndryshuar. Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Llogaritja të bëhet duke u mbështetur në VKM nr. 354, datë 23/05/2016 (Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikeqyrje dhe Kolaudim),

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikeqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente . Licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës për mbikeqyrjen e objekteve. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Meqenese kemi te bejme me mbikeqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se Kategorite e mesiperme jane percaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor për ndjekjen e supervizionit minimalisht. Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin një listë të stafit kryesor të mëposhtem, të cilët duhet të kenë një marrëdhënie kontraktore me operatorin apo partneret në rastin e një bashkimi operatorësh. Për çdo pozicion, operatorët janë të lirë të propozojnë me shumë se një kandidat, me qëllim përmbushjen e kriterëve të kërkuara. Pozicionet e stafit kryesor të kërkuar janë si më poshtë:

- | | |
|--|-----------|
| • Inxhinier Ndërtimi | 4 (kater) |
| • Inxhinier Gjeodet | 2 (dy) |
| • Kontrollor Cilesie | 2 (dy) |
| • Kontrollor i volumeve të punës (Quantity Surveyor) | 2 (dy) |
| • Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE) | 2 (dy) |

htu Operatori Ekonomik duhet të propozojë Staf Inxhinierik “Ing. Resident” që do të ndjekë punimet çdo ditë në terren, operatori ekonomik do duhet që në çdo kantier të ketë një Ing. Resident.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, për secilin prej inxhinierëve të lartpërmendur Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin;

- kualifikimet arsimore (diplomat),
- kualifikimet profesionale (licencat profesionale),
- CV.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9

Në këtë rast, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Per stafin e angazhuar - Marreveshje/kontrate shërbimi apo deklarate nga vete eksperti me nje akt noterial ku te shprehe angazhimin me operatorin fitues kundrejt zbatimit te shërbimit te mbikëqyrjes per kete object procurimi (pershkrim per funksionin/rolin qe do te kryeje dhe detyrat perkatese)

Shenim: Për efekt të vlerësimit me pike sipas pikës 4.4 ne Njoftimin e Kontrates, operatorët të ngarkojnë dokumentacionin: CV, certifikata/diploma/kualifikime profesionale si dhe per Drejtues i Ekipit licencen profesionale për mbikëqyrje.

Gjithashtu per stafin e propozuar te paraqitet informacioni i kerkuar mbi ekperiencen specifike, sipas percaktimeve te Aneksit nr 1 pjese e ketij DT:

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të disponojë jo më pak se 14 punonjës të siguar për çdo muaj për periudhën 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar këtë kusht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën për periudhën 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet të përputhet me listë pagesat e punonjësve për këtë periudhë.

Shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.”

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur duke u bazuar ne shërbimet e kerkuara sipas Termave te references.

-Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e- tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar

në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se AK të japë kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

- Argumentimi: Referuar në nenin 41 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.” Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me numrin e objekteve të kontratës së zbatimit dhe vendndodhjen e tyre. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe mbikeqyrjen e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm gjatë mbikeqyrjes së objekteve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për kolaudimin sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe brenda kushteve të kontratës. Në lidhje me inxhinierin e mjedisit operatori/ët ekonomik/ë gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ku në nenin 1 parashikohet shprehimisht: “Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit” dhe VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo operator ekonomik, person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Roli i inxhinierave është përcaktuar dhe në Termat e References.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- | | |
|---|-----------------|
| 1. Çmimi | pikët 50 |
| 2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë | pikët 10 |
| 3. Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit | pikët 10 |
| 4. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar | piket 30 |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0-50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Shënim: Oferta duhet të hartohet në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.5.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit. Vlerat minimale e fondit limit për supervizimin është: 10,677,083leke pa TVSH. Vlerat maksimale e fondit limit për supervizimin është 12,812,500 leke pa tvsh

2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë

[0 - 10 pikë]

Argumentimi: Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të shërbimit të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/kontratat e ngjashme të kryera përtej minimumit të kërkuar garantojnë AK që me qëndrueshmërinë në treg, eksperiencën e stafit teknik dhe të vetë organizatës të fituar si dhe kapacitetin e lartë teknik kontraktori mbikqyrës nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës së punimeve

Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë kontrata me vlerën më të lartë për objekte të ngjashëm përtej minimumit të percaktuar në kriterin e kualifikimit pika 2.3.1/a, Shtojca 8 dhe që janë realizuar në periudhën kohore brenda tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ofertuesi me vlerën e kontratës së **objektit** të ngjashëm në vlerë absolute më të madhe do ti akordohen pikët maksimale të nën-kriterit dhe ofertuesit e tjerë të kualifikuar (minimalisht sa është percaktuar në pikën 2.3.1/a), Shtojca 8) do ti akordohen pikët sipas metodologjisë/formulës më poshtë:

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\max k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e objektit të ngjashëm)

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për të plotësuar këtë kërkesë ofertuesit mjaftojnë të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.1/a.

3. Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit

[0-10 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë, në drejtim të detyrimeve që rrjedhin për shërbimin e mbikqyrjes sipas legjislacionit në fuqi, duke mos e vënë Autoritetin Kontraktor në kushte që çënojnë kryerjen me cilësi të kontrates së zbatimit të punimeve

Operatori ekonomik duhet të paraqesë metodologjinë dhe strategjinë e monitorimit të zbatimit të punimeve të mbikqyrjes, mënyrën e raportimit, mënyrën e aprovimit të materialeve të cilat do të vendosen në objekt.

Për të plotësuar këtë kriter ofertuesit duhet të paraqesin një dokument i cili duhet të përfshijë mënyrën e realizimit dhe metodologjinë, si dhe burimet e nevojshme për realizimin e mbikqyrjes sipas metodologjisë perkatese. Dokumenti duhet të përshkruajë qasjen e supervizionit, risqet e zbatimit të kontrates, indikatorët cilësorë dhe sasiorë për realizimin e qëllimit të punës, rezultatet e pritshme, sigurimin dhe kontrollin e cilësive, monitorimin e kostos, mbrojtjen e mjedisit, sigurimin teknik dhe shëndetit në punë, raportimin, metodologjinë e dorëzimit të objektit në përputhje me legjislacionin dhe standartet në fuqi etj. Vlerësimi do të bëhet bazuar në plotshmërinë e dokumentit të paraqitur.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij duke iu referuar përcaktimeve në Piken 8/Termat e References

4. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar

piket 0-30

Per Paketën F shpërndarja si më poshtë:

- | | |
|--|------------------|
| 1. Inxhinier Ndërtimi | <i>pike 0-10</i> |
| 2. Inxhinier Gjeodet | <i>pike 0-5</i> |
| 3. Kontrollor Cilësie | <i>pike 0-5</i> |
| 4. Kontrollor i volumeve të punës (<i>Quantity Surveyor</i>) | <i>pike 0-5</i> |
| 5. Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (<i>HSE</i>) | <i>pike 0-5</i> |

Argumentimi: Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të punimeve të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/eksperiencat e ngjashme në të cilat ka qenë angazhuar stafi kyç i propozuar nga kompania demonstron aftësinë teknike dhe profesionale të personave që do të angazhohen gjatë zbatimit të shërbimit të mbikqyrjes, dhe garantojnë AK që me eksperiencën e fituar të tyre kontraktori nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës së punimeve që do të mbikqyret.

Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë eksperiencat e secilit prej stafit kyç të propozuar.

Për të plotësuar këtë kriter ofertuesit do të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.3 dhe njëkohësisht informacion shtesë sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Për të plotësuar këtë kriter ofertuesit do të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.3 dhe njekohesisht informacion shtese sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).